



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:260752

Datë: 24.12.2019

Numri i dokumentit: 00733342

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit NP G. me seli në Gj. kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, duke vepruar sipas Aktgjykimit AA.nr.115/2014 i datës 12.04.2018 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në seancën publike të mbajtur me datë 18.12.2019, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet Kërkesëpadia e paditësit NP G. me seli në Gj., si e bazuar.

Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.05.2.1/597 i datës 18.07.2011 i Doganës së Kosovës në Prishtinë

A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura ka refuzuar kërkesën e paditësit, për rishqyrtimin e vendimit R-4574/16.05.2011 të Zyrës Doganore Dheu i Bardhë, si e pabazë.

Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktgjykimin AA.nr.115/2014 datës 12.04.2018 ka aprovuar padinë e paditëses Dogana e Kosovës, ka anuluar aktvendimin e BPR A.nr.274/2011 dt.21.02.2014 dhe lëndën e ka kthyer tek Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal, në rigjykim dhe rivendosje.

Në ankesën drejtuar BPR-së me datë 26.08.2011 dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi deklaroi: me anë të Deklaratës doganore R-4574/16.05.2011, në Degën Doganore Dheu i Bardhë kemi deklaruar për doganim mallin përbërje strukturore dhe matrica tjera, sipas deklaratës doganore, stuko xhami, stuko transplantuese, çimento resini, përbërje strukturore dhe matrica tjera, solvente dhe holluese me përbërje organike, vegla të tjera dore. Zyrtarët doganor të Degës Doganore Dheu i Bardhë kanë bërë kontestimin e vlerës së këtij malli dhe pastaj kanë caktuar vlerë të re doganore në shumë më të lartë duke e arsyetuar në përdorimin e të dhënave të disponueshme të Doganës dhe në bazë të çmimeve të transaksioneve identike, pra duke u bazuar në metodën e dytë dhe të gjashtë. Edhe pse Doganës i kemi prezentuar të gjitha dokumentet, prapsepapë zyrtarët doganor kanë bërë kontestimin e vlerës së mallit dhe jemi obliguar që të bëjmë pagesën e një shume më të madhe në emër të taksave doganore se sa që na ka takuar në bazë të vlerës së transaksionit. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: mbetem në tërësi pranë të gjitha pretendimeve të cilat i ka paraqitur pala paditëse, Kompania G. nga Gjilani duke i propozuar gjykatës

që pas shqyrtimit të vërejtjeve të dhënave të Gjykatës së Apelit të Kosovës në aktvendimin e saj siç është në shkresat e lëndës, të aprovoi kërkesëpadinë e paditësit dhe ta obligoj të paditurën Doganën e Kosovës që të detyroi të njejtën që ti përmbush të gjitha obligimet të cilat rezultojnë nga transaksionet të cilat i kanë pasur në vitin kur edhe ka lindur kontesti.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: e kundërshtojmë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, konsiderojmë se vendimi i marrë është në përputhje me dispozitat ligjore të aplikueshme nga Dogana e Kosovës. Paditësi me rastin e zhdoganimit të mallit, nuk ka ofruar prova me të cilat do të dëshmonte se çmimi i paguar për mallin kontestues është real. Mbi bazën e kësaj edhe ka bërë rivlerësimin e mallit, duke u bazuar në nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, përkatësisht metodën e 6-të rivlerësimit, dhe me rastin e rivlerësimit të mallit, si referencë janë përdorur Deklaratat unike doganore, me nr. 10770, e datës 18.10.2010, Deklarata 12871, e datës 20.12.2010, dhe Deklarata 2307 e datës 26.03.2011, të Zyrës Doganore Dheu i Bardhë. Deri te ky rivlerësim siç u cek edhe më lartë ka ardhur për faktin se dokumentacioni i prezantuar është konsideruar i pa mjaftueshëm, nga se paditësi nuk ka prezantuar deklaratën eksportuese nga autoritetet doganore të shtetit dërgues, e njehta nuk ka përmbajtur shënime me vlerën e mallit, andaj mbi bazën e kësaj ka ardhur edhe deri te rivlerësimi i mallit.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës; 18.12.2019, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e datës 28.12.2015.2017 nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime, aktvendimi nr.05.2.1/597 i datës 18.07.2011 nga Dogana e Kosovës, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave i datës 16.05.2011, ankesa e paditësit me nr.prot 274-DK i datës 26.08.2011, Deklarata Doganore, të dhënat e disponueshme nga Dogana e Kosovës, Deklarata Unike Doganore nr. R-510770/18.10.2010, R-12871/20.12.2010, R-2307/26.03.2011 të Zyrës Doganore Dheu i Bardhë, certifikata me nr. 003883 e datës 25.02.2010, fatura e mallit, pagesa bankare.

Gjykata pas pranimit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, analizimit të vërejtjeve, duke vlerësuar gjendjen faktike nga shkresat e lëndës, shkaqet e aktvendimit kontestues të goditur si dhe duke vlerësuar provat e reja të siguruara në procedurën e konfliktit administrativ, konstaton se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Në këtë procedurë të konfliktit administrativ në rigjykim, gjykata ka vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në Aktgjykimin AA.nr.115/2014 datës 12.04.2018 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është kërkuar të shqyrtohet ligjshmëria e aktit administrativ nr.05.2.1/597 dt.18.07.2011 i Doganës së Kosovës

Nga shkresat e lëndës rezulton se Dogana e Kosovës me vendimin administrativ përfundimtar nr.05.2.1/597 dt.18.07.2011, ka refuzuar si të bazuar ankesën e paditësit, lidhur me ankesën e ushtruar kundër vendimit 4574/16.05.2011 i Zyrës Doganore Dheu i Bardhë, si të pabazë.

Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura ka mbështetur rivlerësimin e zyrës doganore e cila vlerësimin e mallit e ka bërë bazuar në metodën e 6 të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës. Rivlerësimi i mallit është bërë bazuar edhe në mallrat që kanë vlerë me çmim shumë më të lartë se vlera e deklaruar, DUD-at R10770/18.10.2010, 12871/20.12.2010, 2307/26.03.2011 të zyrës doganore Dheu i bardhë. Dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor e konsideron si provë e pamjaftueshme me arsyetimin se paditësi nuk ka paraqit kontratë të shitblerjes, deklaratat eksportuese nuk ka të specifikuar vlerën e mallit konform faturës së mallit, andaj nuk mund të pranohet pretendimi se paditësi ka

prezantuar dokumentacion të kompletuar dhe valid për aplikimin e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 te Kodit Doganor dhe te Akcizave nr. 03/L-109.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor sipas faturës përcjellëse të mallit date 13.05.2011. Nga provat e administruara gjykata konstaton se urdhërpagesa bankare e dt.06.05.2011 ka vlerën prej 48.741,49€ e cila pages figuron në emër të profaturës nr.29/27.04.2001, mirëpo kjo vlerë e pagesës nuk harmonizohet me vlerën e faturës përcjellëse të mallit dt.13.05.2011 që ka vlerën 48,644.200€, dhe nuk harmonizohet me numrin e faturës përcjellëse të mallit doganor. Nga një mos harmonizim i tillë i dokumentacioneve të paraqitura, gjykata pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues të paditurës, e cila në këtë rast e ka vlerësuar si provë të pamjaftueshme dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor të deklaruar nga paditësi.

Si fakte vendimtare që kanë ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, ka qenë se e paditura Dogana e Kosovës posedon të dhënat e disponueshme nga dosja e vlerës për llojin e mallit të njëjtë dhe çmime me vlerë më të lart të transaksionit se sa vlera e deklaruar DUD-at R10770/18.10.2010, 12871/20.12.2010, 2307/26.03.2011 të zyrës doganore Dheu i Bardhë. Gjkata vlerëson se vendosja e çmimeve sipas të dhënave të disponueshme është provë e bazuar për tu vlerësuar malli lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejtë dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor sipas të dhënave të disponueshme.

Nga provat e administruara gjykata nuk ka gjetur fakte të bazuara që argumentojnë se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale të mallit lëndor sipas faturës përcjellëse të mallit, prandaj gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor nga zyra doganore duke aplikuar metodën e 6 te vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave përkatësisht të dhënave të disponueshme.

Gjkata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor. Në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi nr.5.2.1/597 i datës 18.07.2011 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.1010/18 datë 18.12.2019

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.